



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 120 Prot.

Tiranë, më 17. 01. 2022

V E N D I M

Nr. 18, Datë 17 / 01 / 2022

Bazuar në nenin 33/11, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, dhe nenit 33/11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën me nr. 56 Regj., datë 06.04.2021, të paraqitur nga shtetasi D. M, kundër Bashkisë Kukës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “bindjeve politike”.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 186, datë 30.09.2021, me anë të të cilit ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit të ankuarit D. M, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kukës”.

Në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioneri ka vendosur që: “Bashkia Kukës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankuar në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të”, si masë konkrete për të përmirësuar situatën diskriminuese.

Bashkia Kukës, megjithëse mori dijeni për Vendimin sipërcituar që me datë 01.10.2021, me anë të kuponit postar të lajmërim marrjes me nr. RR 653 353 757 AA, nuk ka sjellë asnjë përgjigje shkresore pranë KMD-së lidhur me marrjen e masave për zbatimin e tij, si dhe as nuk e ka kundërshtuar atë gjyqësisht, konform afateve ligjore të përcaktuara.

Në vijim të monitorimit të zbatimit të vendimit sipërcituar, nëpërmjet shkresës me nr. 1377/2 prot., datë 16.12.2021, KMD i ka dërguar Bashkisë Kukës një kujtesë lidhur me detyrimin për ta njoftuar për masat e ndërmarra, në zbatim të Vendimit të Komisionerit.

Megjithë marrjen dijani të shkresës sipërcituar, që me datë 17.12.2021, vërtetuar nëpërmjet kuponit postar të lajmërim marrjes me nr. RR 259 220 917 AA, Bashkia Kukës nuk ka solli asnjë përgjigje zyrtare lidhur me sa ishte kërkuar.

Në vijim të procedurave të shqyrtimit të çështjes, në mungesë të zbatimit të vendimit, Komisioneri me Vendimin Nr. 03, datë 06.01.2022, ka vendosur që: *“Subjekti Bashkia Kukës, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë”*.

Me shkresën nr. 84 prot., datë 10.01.2022, Bashkia Kukës, ka informuar Komisionerin se:

“Në zbatim të Vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për rikthimin në punë të D. M, në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barazvlefshëm me të, ju informojmë se janë marrë masat për zbatimin e këtij vendimi. Është bërë takimi me D. M dhe pasi ai ka pranuar punësimin në pozicionin e ofruar, me Urdhrin nr. 09, datë 10.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar në detyrë, në pozicionin Specialist i Kontrollit të Territorit në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve. Licencave, të Bashkisë Kukës”.

Sa më sipër është konfirmuar edhe nga subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit dërguar KMD-së, me datë 14.01.2022.

Bazuar në sa më sipër, si dhe mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, nenin 33/11, i cili përcakton se: *“....Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”*, Komisioneri arrin në përfundimin se është zbatuar Vendimi, nr. 186, datë 30.09.2021.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33/11, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e Vendimit me gjobë Nr. 03, datë 06.01.2022, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

2. Të njoftohen palët për këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA